



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 101, datë 23.03.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu dhe Ervin Sulaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Neni 76 dhe 22 i Kodit Penal”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ervin Sulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Neni 88/1 të Kodit Penal”.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Neni 100/2 të Kodit Penal”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 76, 22 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu dhe Ervin Sulaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 78 dhe 278/4 të Kodit Penal”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ervin Sulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 283/a/2 e 22 të Kodit Penal”.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ervin Sulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 236/2 dhe 274 të Kodit Penal”.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; akuza: “Nenet 114/2, 115 dhe 113/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Lazër Sallaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; akuza: “Nenet 79/ë, 22, etj. të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Arjeta Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen gjyqësore me kërkesë: {...}; objekti: “Kërkesë për heqje zotësie”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Entela Gjoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 79/dh dhe 278/1/3 të Kodit Penal”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 298/3, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me kërkes: {...}; objekti: “Pushimin e procedimit penal nr. {...}, datë 11.06.2018”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; objekti: “Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëimin nr. {...}, viti 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me paditës: {...}; i paditur: {...}; objekti: “Dhënie autorizimi për të dalë jashtë shtetit për fëmijët e mitur”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me paditës: {...}; të paditur: {...}, etj.; objekti: “Lirim dorëzim trualli”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR